



# VOTO PËR

B A R A Z I  
DHE MOSDISKRIMINIM

ARGUMENTET  
PËR MIRATIMIN  
E LIGJIT TË RI PËR  
PARANDALIMIN  
DHE MBROJTJEN  
NGA DISKRIMINIMI  
(LPMD)



RRJETI  
NACIONAL  
PËR LUFTË KUNDËR  
HOMOFOBISË  
DHETRAFSOBISË

Rrjeti nacional për luftë kundër homofobisë dhe transfobisë (RRNHT) është rrjet i më shumë se 20 organizatave dhe grupeve joformale, të cilat në mënyrë aktive punojnë në avancimin e të drejtave të personave LGBTI, barazinë gjinore, të drejtat e bashkësive të marginalizuara dhe të rinjtë.

## 1. FUTJA E ORIENTIMIT SEKSUAL DHE IDENTITETIT GJINOR DO TË NËNKUPTOJË PLOTËSIM I DETYRIMEVE QË REPUBLIKA E MAQEDONISË I KA NDËRMARRË PËRPARA ORGANEVE NDËRKOMBËTARE DHE RAJONALE TË DREJTAVE TË NJERIUT, DUKE PËRFSHIRË BASHKIMIN EVROPIAN, KËSHILLIN E EVROPËS DHE KOMISIONET E ORGANIZATËS SË KOMBEVE TË BASHKUARA

- ▶ BE-ja rregullisht i vuri në dukje Republikës së Maqedonisë që orientimi seksual dhe identiteti gjinor nuk janë përfshirë në LPMD dhe se Komisioni për Mbrojtjen nga Diskriminimi nuk është institucion mjaft efikas, profesional dhe i pavarur. Në raportin e vitit 2018, Komisioni Evropian rekomandoi që të miratohet Projekt-ligji për mbrojtjen dhe parandalimin nga diskriminimi dhe ligjet tjera të harmonizohen me të.<sup>1</sup>

## 2. PERSONAT LGBTI JANË NJË NGA GRUPET ME RREZIK MË TË MADH NGA DISKRIMINIMI

- ▶ Qytetarët e Maqedonisë janë relativisht tolerantë për të jetuar në lagjet e përbëra nga grupe të ndryshme/ përziera. **Përrjashtimi është tolerance ndaj fqinjit homoseksual, ku vlerësimi mesatar i ndjenjës është 4 në shkallën 1-9.**<sup>2</sup>
- ▶ Për shtetasit maqedonas, **homoseksualët janë një nga grupet më pak të pranueshëm për bashkëqytetarët (31.7%).**<sup>3</sup>
- ▶ **100% e trans personave të anketuar kanë qenë viktime të formave të ndryshme të diskriminimit** d.m.th. forma më të rënda diskriminimi si diskriminim i zgjatur dhe i shumëfishtë.<sup>4</sup>
- ▶ **36.8% e personave LGBT kanë ndjerë diskriminimin në vendin e punës, 39% diskriminimi në ushtrimin e të drejtave të mbrojtjes sociale, dhe 30,77% diskriminimin e pësuar në bazë të orientimit seksual dhe identitetit gjinor në raportimin e rasteve në stacionin e policisë.**<sup>5</sup>

- ▶ Prej 2015 deri sot, anëtarët e RNHT kanë dokumentuar **144 raste të shkeljeve të të drejtave të personave LGBTI për shkak të orientimit seksual dhe identitetit gjinor.** Në shumicën e rasteve, bëhet fjalë për diskriminim, gjuhën e urrejtjes ose dhunën e urrejtjes.

## 3. NGA VITI 2005 DERI MË TANI JANË MIRATUAR TETË LIGJE NË FUSHA TË NDRYSHME QË PËRFSHIJNË ORIENTIMIN SEKSUAL SI BAZË PËR DISKRIMINIM, KËSHTU QË ËSHTË LOGJIKE QË LPMD, SI NJË LIGJ GJITHËPËRFSHIRËS PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI, TË PËRMBAJË TË GJITHA BAZAT POTENCIALE PËR DISKRIMINIM

### Orientimi seksual është përmendur në ligjet në vijim:

- ▶ Ligji për Shëndetin Publik në pjesën që i referohet procedurës së Institutit për Shëndet Publik dhe Qendrave, Neni 16;
- ▶ Ligji për Arsimin e Lartë në pjesën që i referohet procedurave dhe kërkesave për regjistrim, Neni 108;
- ▶ Ligji për Mbrojtjen e të Drejtave të Pacientëve në seksionin e të Drejtave të Pacientëve, Neni 5;
- ▶ Ligji mbi Familjen, në seksionin për viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore dhe familjeve të tyre, neni 177-l;
- ▶ Ligji për Themelimin e Agjencisë Kombëtare të Programeve të Edukimit dhe Lëvizshmërisë në pjesën e programit “Rinia në Veprim”, nenet 7 dhe 8;
- ▶ Ligji për Shërbime Audio dhe Audio-vizuale në fushën e komunikimeve audio-vizuale komerciale, Neni 53;
- ▶ Ligji për Marrëdhëniet e Punës, neni 6 ndalon diskriminimin e bazuar në “drejtimin seksual” që mund të konsiderohet si terminologji diskriminuese që i referohet vetëm akteve seksuale, duke mos përfshirë të gjitha aspektet që e përbëjnë orientimin seksual.



**36.8% e personave LGBT kanë ndjerë diskriminimin në vendin e punës**

1 The former Yugoslav Republic of Macedonia 2018 Report, EUROPEAN COMMISSION, Strasbourg, 17.4.2018

2 Barometri i mundësive të barabarta, Jasmina Mihailovska, Misha Popoviq. 2013 Shkup QMBN

3 KULTURA E POLITIKËS, IDENTITETËT DHE SHOQËRIA QYTETARE, FSHHM, 2017 (në shkrim)

4 Hulumtim në komunitetin “Përvoja transgjimore: identitetet, trupet, dhuna dhe shoqërimi”, Sllavčo Dimitrov, Koalicioni Margjine, 2018.

5 Analiza e problemeve dhe nevojave të personave LGBTI në Republikën e Maqedonisë në fushën e mbrojtjes sociale, shërbimeve ligjore dhe procedurave policore, Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut në Republikën e Maqedonisë – LGBTI Qendra për mbështetje

#### 4. KOMISIONI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI NUK I PËRMBUSH STANDARDET E PAVARËSISË, EKSPERTIZËS DHE PROFESIONALIZMIT

- ▶ Rrjeti për mbrojtje nga diskriminimi e ka identifikuar problemin me kriteret për përzgjedhjen e anëtarëve të Komisionit, lidhja e anëtarëve me partinë që në atë kohë ishte në pushtet, dhe mungesa e njohurive dhe përvojës në fushën përkatëse.<sup>6</sup>

- ▶ Komisioni Evropian dhe Komiteti për të Drejtat Ekonomike, Kulturore dhe Sociale ishte organi i parë që rekomandoi profesionalizimin e këtij organi dhe garanci më të forta për pavarësi politike dhe financiare në përputhje me *Parimet e Parisit*.<sup>7</sup>

- ▶ Edhe në raste të dukshme të diskriminimit, ku institucionet e tjera dhe organet për barazi kanë përcaktuar diskriminim, Komisioni për Mbrojtjen nga Diskriminimi nuk ka përcaktuar diskriminim.



BE rregullisht i ka bërë vërejtje RM-së se Komisioni për mbrojtje nga diskriminimi nuk është institucion i mjaftueshëm efikas, profesional dhe i pavarur.

#### SHEMBULL 1:

	Numri i ankesave për gjuhën e urrejtjes ndaj LGBTI të paraqitura nga anëtarët e RNHT <sup>8</sup>	Është përcaktuar gjuha e urrejtjes / ngacmimi	Nuk është përcaktuar gjuha e urrejtjes / ngacmimi	Nuk ka përgjigje edhe pse afati ka skaduar
Komisioni për Mbrojtjen nga Diskriminimi	6	1	3	2
Këshilli i Etikës në Media	6	6	/	/

#### SHEMBULL 2:

Numri i ankesave në KMD bazuar në orientimin seksual dhe identitetin gjinor nga 2015 deri më sot të paraqitura nga anëtarët e RNHT	Ankesa për të cilat është përcaktuar diskriminimi	Ankesa për të cilat nuk është përcaktuar diskriminimi	Ankesa për të cilat akoma nuk ka përgjigje edhe pse afati ka skaduar	Ankesa për të cilat Komisioni ka dhënë përgjigje të paqartë ose e ka ndaluar procedurën
18	3	10	2	3

6 "Mendojmë se Komisioni në përbërjen aktuale nuk i plotëson as standardet minimale për pavarësi dhe nuk mundëson liri dhe disponueshmëri të plotë për të gjitha grupe të qytetarëve që konsiderojnë se janë të diskriminuar, posaçërisht ata me diskriminim në bazë të përkatësisë politike dhe etnike." Rrjeti për mbrojtje nga diskriminimi, 13.1.2016

7 Principles relating to the Status of National Institutions (The Paris Principles), Adopted by UN General Assembly resolution 48/134 of 20 December 1993

8 Për të gjitha rastet e gjuhës së urrejtjes Koalicioni Margini ka dorëzuar parashtrësë edhe deri te Komisioni për mbrojtje nga diskriminimi dhe deri te Këshilli për etikë në medime.

## 5. SHPENZIMET JOEFKTIVE TË PARAVE BUXHETORE TË DESTINUARA PËR MBROJTJEN DHE PARANDALIMIN E DISKRIMINIMIT

Në vitin 2011, kur Komisioni filloi punën, u parashtruan 60 ankesa, ndërsa në vitin 2017, 59 ankesa! **Institucioni për shtatë vjet punë nuk ka arritur të fitojë besimin e qytetarëve dhe të avancojë pozitën e tij si një organ i barazisë që i mbro qytetarët nga diskriminimi.**


Zgjidhja e çdo ankese është shumë e shtrenjtë, kurse nga ana tjetër, Komisioni pothuajse nuk ka kryer aktivitete për parandalimin e diskriminimit. Anëtarët e Komisionit marrin honorar me vlerë prej dy pagave mesatare mujore (rreth 46 000 denarë në muaj) dhe në vitin 2017 ata kanë zgjidhur vetëm 59 ankesa gjithsej. **Çdo anëtar ka marrë 46 000 denarë në vitin 2017 për të vendosur 0.7 ankesa në muaj!**

## 6. PROFESIONALIZIMI I KOMISIONIT NGA NJËRA ANË DO TË THOTË AVANCIM I MBROJTJES DHE PARANDALIM I DISKRIMINIMIT, POR DO TË THOTË EDHE SHFRYTËZIM EFIKAS DHE TË QËLLUAR TË MJETEVE BUXHETORE

Projekt-ligji për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi parashikon reformën e plotë të kornizës institucionale të Komisionit për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe të procedurës me qëllim që të bëhet një organ profesional, i pavarur dhe efikas për barazi.

Disa nga masat që, nëse zbatohen siç duhet, do t'i përmirësojnë mungesat dhe kritikrat e punës së Komisionit janë:

- ▶ Kriteret për përzgjedhjen e anëtarëve: minimum shtatë vjet përvojë në fushën e të drejtave të njeriut, nga të cilat pesë vjet në fushën e mosdiskriminimit.
- ▶ Anëtarët e Komisionit do të kenë statusin e personave të emëruar që kryejnë funksionin profesionalisht dhe ky funksion nuk do të jetë në lidhje me ndonjë funksion tjetër publik, me funksion në ndonjë parti politike ose në vend tjetër pune.
- ▶ Komisioni do të disponojë në mënyrë të pavarur me përdorimin, alokimin dhe shfrytëzimin e mjeteve të punës.
- ▶ Rritja e kompetencave të Komisionit me fokus më të madh në parandalimin e diskriminimit.
- ▶ Shkurtimi i afatit në të cilin Komisioni është i detyruar të japë opinion prej 90 në 45 ditë.
- ▶ Mundësi për padi për mbrojtjen nga diskriminimi në interesin publik (Actio popularis).
- ▶ Përgjegjësi nga pagesa e taksave gjyqësore për qytetarët të cilët do të nisnin procedurë ligjore për mbrojtje nga diskriminimi.



Me qëllim që anëtarët e Komisionit t'i përgjigjen në mënyrë adekuate kompetencave të zgjeruara dhe kornizës së re institucionale, dhe veçanërisht duke marrë parasysh jo kompetencën dhe paragjykimin personal, sidomos ndaj komuniteteve të ndryshme etnike dhe personave LGBTI të demonstruar nga disa anëtarë të Komisionit, ligji parashikon që me datën e hyrjes në fuqi ta ndërpresë mandatin e anëtarëve të Komisionit për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe ata të vazhdojnë të punojnë deri në zgjedhjen e anëtarëve të rinj, por jo më shumë se tre muaj.